



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 130, Datë 16.08.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EUROBIZNES” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC-et: “LUSEN 1” ME FUQI TË INSTALUAR 0.315 MW; “LUSEN 2” ME FUQI TË INSTALUAR 0.6 MW; “LUSEN 3” ME FUQI TË INSTALUAR 0.6 MW; DHE ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 1.515 MW.

Nëmbështetjetëneve 16 dhe37, pika 2, germa “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; VKM Nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike”, nëneve 4 pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 10 pika 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 109, datë 29.06.2016; neni 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.08.2017, mbasishqyrtoirelacionine përgatitur për fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “EUROBIZNES” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë EUROBIZNES sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si me poshtë :

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”), është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9 pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik për HEC, (neni 9, pika 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3 gërmat “a”, “b”; 4.1.4) është plotësuar tërësisht.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Nenin 9, pika 4.1.3, gërma “c” Shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencatekzakte (numër parcele, numër rregjistri kadastrë) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1: 25000 dhe gërma “d” Një hartë topografike ku të praqitet gjurma e linjës transmetuese në shkallë 1: 25000 -

- Nenin 9, pika 4.1.5, gërma “a” miratimi i pikës së lidhjes dhe gërma “b” leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike, do të njoftohet subjekti që në bazë të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”*, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Përgjithësisht, Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EUROBIZNES” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Lusen 1” me fuqi të instaluar 0.315 MW; “Lusen 2” me fuqi të instaluar 0.6 MW; “Lusen 3” me fuqi të instaluar 0.6 MW; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 MW, për një afat 30 – vjeçar.
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë subjektin e interesuar për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.